



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**V E N D I M**

**Nr. 49, datë 09.03.2022**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi ankesën nr. 172, datë 23.09.2021, të z. M.G., ku pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore”, nga ana e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë dhe Departamentit të Administratës Publike.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas informacionit të dhënë në ankesë, z. M.G. punon prej vitit 2016 pranë institucionit të Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë, në pozicionin e specialistit në Sektorin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave. Ai është arsimuar përgjatë viteve 1982-1985, në Akademinë e Forcave Tokësore “Skënderbej” Tiranë, e në vijim përgjatë periudhës kohore 04.09.2006 – 06.07.2007, ai ka kryer studimet pranë Shkollës së Lartë Shumëdegëshe të Luftës, në Selanik, Greqi.

Ankuesi sqaron se në vitin 2020, ka konkuruar në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, i cili është shpallur vakant nga ana e Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë, por pavarësisht se i plotësonte të gjitha kriteret arsimore për të konkuruar, ai është skualifikuar, që në fazën e parë të këtij konkurimi.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD;

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD;

Njoftimi për skualifikim i është dërguar me e-mail në datën 17.09.2020, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, të këtij institucioni, ku ankuesi sqarohet se skualifikimi mbështetet në faktin se në dokumentacionin e tij mungon niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”, apo “Master Profesional” të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike në Arsimin e Lartë Ushtarak/Policor/Shkenca Inxhinierike. Ky arsytim është mbështetur në faktin se Diploma e tij e Shkollës së Lartë Shumëdegëshe të Luftës, në Selanik, Greqi nuk është e njehsuar nga autoritetet përkatëse.

Ankuesi thekson faktin se i është drejtuar me ankesë, Departamentit të Administratës Publike (DAP), i cili fillimisht ka pezulluar procedurat e konkurrimit, për të kryer verifikimet përkatëse. Në vijim, ky institucion e ka njoftuar, se ai nuk plotëson kriterin e sipërcituar, si dhe ka theksuar faktin se diploma e tij e fituar jashtë shtetit, në Shkollën e Lartë Shumëdegëshe të Luftës në Greqi nuk është në proces njehsimi nga Akademia e Forcave të Armatosura, që është i vetmi institucion publik i arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes së sigurisë kombëtare, pranë së cilit funksionon Bordi i Ekuivalentimit të diplomave të lëshuara nga vendet e huaja.

Z. M.G. pretendon se e ka sqaruar Departamentin e Administratës Publike, duke vënë theksin në çështjen se Bordi i Ekuivalentimit të Diplomave të Huaja, pranë Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA) nuk funksionon dhe se ai ka depozituar disa herë kërkesa pranë AFA-s për ekuivalentimin e diplomës së tij të fituar në Greqi.

Pozicioni i Përgjegjës të Sektorit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave është shpallur vakant sërish në vitin 2021. Ankuesi shprehet se ka qenë në kontakt me DAP, në lidhje me çështjen e njehsimit të diplomës së tij të Shkollës Shumëdegëshe të kryer në Greqi. Në këtë pozicion pune ka fituar dikush tjetër që është marrë në punë jashtë shërbimit civil.

Në këto kushte, ankuesi M.G. pretendon se është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore nga Prefekti e Qarkut Gjirokastrë dhe Departamenti i Administratës Publike.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>3</sup>, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

---

<sup>3</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “etnisë”, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7, i LMD, i ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj në nenin 12, pika 1, gërmat a) dhe b) parashikon shprehimisht se: “1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve, trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;”

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A. Pas analizimit të ankesës nr. 172, datë 23.09.2021, së z. M.G., si dhe pas korrespondencës së patur me e-mail me ankuesin, u konstatua se nga pikëpamja formale,

ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

**B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>4</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, Departamentit të Administratës Publike<sup>5</sup>, si dhe për dijeni Akademisë së Forcave të Armatosura<sup>6</sup> dhe subjektit ankues, me shkresën nr. 1330/2, datë 06.10.2021, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:

1. Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
2. Kopje e shpalljes për konkurim të pozicionit të Përgjegjës të Sektorit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, pranë Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë;
3. Kopje e listës së konkurentëve për çdo fazë të konkurimit -1- lëvizje paralele, 2- ngritje në detyrë, 3- konkurim jashtë shërbimit civil;
4. Informacion mbi fituesin e këtij pozicioni pune;
5. Kopje të aktit nëpërmjet së cilit, ankuesi është njoftuar për skualifikimin e tij.
6. Kopje e korrespondencës zyrtare, ose me e-mail me ankuesin, lidhur me çështjen e skualifikimit të tij, në konkurimin e zhvilluar për pozicionin e sipërcituar;
7. Kopje e aktit të emërimit në detyrë dhe librezës së punës së ankuesit;
8. Kopje e diplomave universitare dhe pasuniversitare të ankuesit;
9. Kopje të korrespondencës zyrtare me AFA-n dhe Ministrinë e Mbrojtjes, lidhur me çështjen e z. M.G.;
10. Informacion mbi vlerësimet në punë të ankuesit nga viti 2016 e në vijim;
11. Informacion nëse ndaj ankuesit janë dhënë masa disiplinore;
12. Kopje e shkresës nr. 2042/2, datë 25.06.2021, të AFA-s, dërguar Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë;
13. Çdo informacion tjetër, që ka lidhje me çështjen objekt ankese.

Për efekt të hetimit të kësaj ankese, nëpërmjet shkresës së sipërcituar, KMD kërkoj informacion edhe nga Akademia e Forcave të Armatosura, si vijon:

<sup>4</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

<sup>5</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin DAP;

<sup>6</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin AFA.

1. Informacion nëse z. M.G. ka depozituar kërkesë pranë Bordit të Ekuivalentimit të Diplomave të Huaja, për njohjen të diplomës së tij. Nëse po, lutemi të dërgohet kopje e kërkesës të tij dhe përgjigjes zyrtare të AFA-s;
  2. Informacion nëse është kryer njehsimi i diplomës, që ankuesi ka fituar në Greqi. Nëse ky ekuivalentim nuk është kryer, të jepen arsyet mos kryerjes së tij;
  3. Informacion mbi procedurat që duhen ndjekur për ekuivalentimin e diplomave të huaja pranë AFA-s;
- Në përgjigje të shkresës së KMD-së, AFA dërgoi shkresën nr. 3222/1, datë 11.10.2021, nëpërmjet së cilës informon shprehimisht si më poshtë:

*“ 1. Duke filluar nga viti 2019 deri në vitin 2021 zoti M.G. ka depozituar disa kërkesa në lidhje me studimet e kryera në Shkollën e Lartë Shumëdegëshe, sot Kolegji i Bashkuar i Luftës në Selanik, Greqi, për të cilën kërkon ekuivalentimin e diplomës së akademisë ushtarake 1 vjeçare të përfuturuar në Greqi me diplomë të masterit profesional/shkencor në Republikën e Shqipërisë.*

*2. Kolegji i Bashkuar i Luftës për tre llojet e forcave, ku është diplomuar zoti M.G., sipas sistemit të arsimit ushtarak në Republikën e Shqipërisë ekuivalentohet me kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP), referuar Urdhërit nr. 178, datë 27.01.2017, të Ministrit të Mbrojtjes, “Për miratimin e tabelës së ekuivalentimit të kurseve institucionale të kryera jashtë shtetit nga personeli i Forcave të Armatosura”, Kreu V. Lista e kurseve institucionale që zhvillohen në Greqi, pika 5, përcaktohet se ky kurs ekivalentohet me KKSHP-në dhe këtë kurs e ndjekin oficerët me gradën major për të përfuturuar gradën nënkolonel në Forcat e Armatosura.*

*3. Në lidhje me kërkesën për njehsimin e diplomës së përfuturuar në Greqi me diplomë Master Profesional, Akademia e Forcave të Armatosura nuk mund të njësojë diplomat ose programet e kurseve që kryhen jashtë shtetit pasi bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të drejtën për njehsimin e certifikatave, diplomave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituara jashtë vendit, e ka Ministria e Arsimit dhe Sportit (Qendra e Shërbimeve Arsimore).*

*4. Praktikat e punës në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Akademinë e Forcave të Armatosura si Institucion i Arsimit të Lartë, bazohen në ligjin nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e Drejtimit e të Komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 124, pikat 3,5,6, si dhe në Urdhërin nr. 178, datë 27.01.2017 e Ministrit të Mbrojtjes, “Për miratimin e tabelës së ekuivalentimit të kurseve institucionale të kryera jashtë shtetit nga personeli i Forcave të Armatosura”.*

*5. Urdhëri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 2012, datë 12.12.2015 “Për miratimin e tabelës së ekuivalentimit të diplomave të lëshuara nga institucionet ushtarake në vite” ekuivalenton vetëm*

*diplomat e Arsimit të lartë Ushtarak të lëshuara nga institucionet ushtarake në vite”, ekuivalenton vetëm diplomat e Arsimit të Lartë Ushtarak të lëshuara nga institucionet ushtarake brenda vendit, para viteve 2003.*

*Në lidhje me ankesat e z. M.G. bëjmë me dije se krahas përgjigjeve individuale të adresuara për z. M.G., i jemi përgjigjur kërkesave të: Drejtorisë së Inspeksionit të Përgjithshëm në MM, Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në MM, Prefektit të Gjirokastrës Zotit Odise Kote, si dhe faqes zyrtare elektronike në platformën e bashkëqeverisjes.*

*Për sa më sipër, bashkëlidhur ju dërgojmë:*

- *Kërkesën e zotit M.G. me nr. 677, datë 25.04.2017;*
  - *Kërkesën e zotit M.G. me nr. 176, datë 04.02.2019 “Vërtetim për njehsimin e diplomës master”.*
  - *Shkresën e AFA-së me nr. 176/1, datë 05.02.2019 “Kthim përgjigje”*
- *Në përgjigje të shkresës së KMD-së, DAP-i dërgoi shkresën nr. 5546/1 prot., datë 14.10.2021, nëpërmjet së cilës, informon se nga të dhënat e administruara nga ky institucion rezulton se z. M.G. ka aplikuar në procedurën e lëvizjes paralele, kodi i shpalljes #3056-lloji i diplomës “Arsim i lartë ushtarak/policor/Shkenca inxhinierike”, niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”, për pozicionin vakant: Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, në Administratën e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë-kategoria III-b. Bazuar në pikat 7 dhe 10, të Kreut VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të ndryshuar, në procedurat e lëvizjes paralele, njësia e burimeve njerëzore të institucionit që ka vendin vakant, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga aplikantët, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin, ose jo kushtet e lëvizjes paralele kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim. Kandidatët që nuk kualifikohen njoftohen individualisht nga njësia e burimeve njerëzore për shkaqet e moskualifikimit. Në procedurën e lëvizjes paralele kodi #3056, kriteri minimal i diplomës së kërkuar ka qenë master shkencor. Kandidati M.G. është skualifikuar nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit ku ka aplikuar (Administrata e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë) me motivin se “nuk plotëson kërkesat e posaçme të nivelit të diplomës “Master Shkencor” apo “Master profesional” të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike”. Diploma që zotëron z. M.G., në degën “Gjitharmësh”, e lëshuar nga Shkolla e Bashkuar e Oficerëve, nr. regj. 5297, me kohëzgjatje 3 vite kalendarike, bazuar në shkresën nr. 85/1 prot., datë 21.03.2017, e Ministrisë së Mbrojtjes drejtuar Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, është ekuivalentuar me nivelin “Bachelor”.*



Pasi ka marrë njoftimin për skualifikimin nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, kandidati z. M.G. ka paraqitur 2 ankesa pranë njësisë përgjegjëse DAP , lidhur me skualifikimin e tij nga procedura e lëvizjes paralele kodit i shpalljes #3056. Në ankesat e tij, përkatësisht të datës 21.09.2020 dhe 22.09.2020, shoqëruar me dokumentacionin shpjegues, kandidati ka pretenduar se skualifikimi i tij nuk është i drejtë, pasi ai ka aplikuar për njehsimin e diplomës që ka fituar jashtë shtetit përkatësisht në Shkollën e Lartë Shumëdegëshe të Luftës në Greqi, por për shkak të vonësive të institucionit përgjegjës (Ministria e Mbrojtjes) nuk e ka marrë njehsimin e diplomës.

Në këto kushte, bazuar në nenin 66, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, DAP ka vlerësuar se ndodhet para një çështjeje paraprake e cila është parakusht për të garantuar të drejtat e nëpunësit civil, si dhe zhvillimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin në fjalë dhe për pasojë ka vendosur të pezullojë procedurën administrative shpalljen kodit #3056, për pozicionin: Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, në Administratën e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë – kategoria III-b, deri në rënien e shkakut të pezullimit dhe zgjidhjes së çështjes paraprake.

Për të zgjidhur çështjen paraprake, pasi ka marrë vendimin e pezullimit të procedurës së lëvizjes paralele, DAP i ka kërkuar Ministrisë së Mbrojtjes, informacion mbi procesin e njehsimit të diplomës së z. M.G., përkatësisht me shkresën nr. 4548 Prot., datë 01.10.2020 “*Kërkesë për informacion*”. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 4301/4 prot., datë 23.10.2020, Ministria e Mbrojtjes ka vënë në dijeni njësinë përgjegjëse se Akademia e Forcave të Armatosura, si i vetmi institucion publik i arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, pranë së cilës funksionon Bordi i Ekuivalentimit të Diplomave të lëshuara nga vendet e huaja, është në pamundësi për të bërë ekuivalentimin e diplomës së fituar nga z. M.G., në Shkollën e Lartë Shumëdegëshe në Greqi dhe se aktualisht Ministria e Mbrojtjes nuk është në proces të njehsimit të diplomës së z. M.G..

Në këto kushte, pasi mori dijeni se Ministria e Mbrojtjes nuk është në proces të njehsimit të diplomës së ankuesit, DAP ka vlerësuar se ka rënë shkak i pezullimit të procedurës dhe për këtë arsye vendosi përfundimin e procesit të pezullimit dhe vijimin e fazave të mëtejshme të procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave*”, në Administratën e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë – Kategoria III-b. Procedura e lëvizjes paralele dhe më pas ajo e pranimit në shërbimit civil, kodit i shpalljes #3056, për pozicionin: Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, në administratën e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë – Kategoria III-b, është mbyllur pa kandidat fitues, pra pozicioni ka mbetur vakant. Referuar planifikimit të nevojave për rekrutim për vitin 2021, DAP rishpalli pozicionin vakant “*Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave*, në Administratën e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë – kategoria III-b, përkatësisht me shpalljen kodit #3605. Në procedurën e lëvizjes paralele kodit #3605 është mbyllur pa kandidatë fitues për këtë pozicion, ndërsa procedura e pranimit në shërbimin civil është

mbyllur me kandidatin fitues. Aktualisht në pozicionin: Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, në administratën e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë – kategoria III-b, është emëruar kandidati fitues në procedurën e pranimit në shërbimin civil, z. E.A. Ky kandidat ka përfunduar studimet në vitin 1989, në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, specialiteti “Ndërlidhje”. Referuar Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 2012, datë 11.12.2015, “Për miratimin e tabelës së ekuivalentimit të diplomave të lëshuara nga institucionet ushtarake në vite”, kjo diplomë ekuivalentohet si “Master Shkencor”. Z. E. A. është kualifikuar në këtë procedurë konkurrimi, pasi ka përmbushur kushtet dhe kriteret e posaçme për vendin e punës.

Lidhur me rishpalljen e pozicionit të punës: Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, në Administratën e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë –kategoria III -b, duke filluar nga data 29.06.2021, z. M.G. i është drejtuar disa herë me e-mail DAP-it duke pretenduar kryesisht se pozicioni nuk duhet të shpallet derisa të interesuarit t’i njehsohet diploma e fituar jashtë shtetit. Ky pretendim nuk mund të merrej në konsideratë nga njësia përgjegjëse, nga momenti që procedurat e konkurrimit udhëhiqen nga parimet e ligjshmërisë dhe mbrojtjes së interesit publik. Në legjislacionin e shërbimit civil nuk ka asnjë dispozitë ku të parashikohet se pozicioni i shërbimit civil qëndron vakant deri në plotësimin e kriterëve të posaçme nga kandidati potencial. Bazuar në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave. “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, kandidatët duhet të plotësojnë njëkohësisht kushtet minimale dhe kriteret e posaçme për vendin e punës, për të cilin aplikojnë. Mosplotësimi i njërit prej këtyre kriterëve, sjell si pasojë skualifikimin e kandidatit nga procedura e konkurrimit. Në mënyrë që DAP, apo njësia e burimeve njerëzore të institucionit, të vërtetojë nivelin e diplomës së fituar jashtë shtetit nga z. M.G., duhet që kandidati të paraqesë dokumentin e njehsimit të diplomës, të lëshuar nga organet publike kompetente të përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” dhe në ligjin nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe të komandimit të Forcave të Armatosura në RSH”.

Bashkëlidhur shkresës së DAP, është dërguar edhe dokumentacioni që dispononte njësia përgjegjëse për kandidatin M.G..

- Në përgjigje të shkresës së KMD-së, Prefekti i Qarkut Gjirokastrë dërgoi shkresën nr. 901/1, datë 15.10.2021, nëpërmjet së cilës sqaron se në zbatim të shkresës nr. 6802 prot., datë 04.11.20216, së DAP ka dalë Urdhëri nr. 105, datë 10.11.2016, i prefektit të Qarkut Gjirokastrë, për emërimin në detyrë të z. M.G.. Me shkresën nr. 2024 prot., datë 07.12.2016, Prefekti i Qarkut Gjirokastrë i është drejtuar MASR-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes, për klasifikim të diplomave dhe vlerën e pagës së grupit për 3 nëpunës civilë, përkatësisht për z. R.Gj., z. Th.K. dhe z. M.G.. Për këtë të fundit është kërkuar klasifikimi edhe për diplomën e përfituar jashtë shtetit, e cila është dërguar bashkëlidhur. Me shkresën nr. 3363, datë



30.03.2017, MAS ka përcjellë përgjigjen zyrtare të AFA-s nr. 85/1 prot., datë 21.03.2017, ku shprehet se z. M.G., me nr. regj. 5297, datë 25.07.1985, 3 vite akademike, 6 semestra ekuivalentohet me diplomë “Bachelor”, ndërkohë që nuk janë shprehur mbi ekuivalentimin e Diplomës së z. M.G., i cili ka mbaruar studimet e larta në Shkollën e Lartë Shumëdegëshe të Luftës, në Kursin e Katërt Arsimit të Shtabit të Përgjithshëm të Mbrojtjes Kombëtare në qytetin e Selanikut, Greqi.

Me shkresën nr. 1128, datë 13.11.2020, Prefekti i Qarkut i është drejtuar përsëri MASR-së si dhe Ministrisë së Mbrojtjes, për ekuivalentimin e Diplomës së z. M.G., i cili ka mbaruar studimet e larta në Shkollën e Lartë Shumëdegëshe të Luftës, në kursin e 4 (katërt) Arsimit të Shtabit të Përgjithshëm të Mbrojtjes Kombëtare në qytetin e Selanikut, Greqi. Në shkresën nr. 6224/1, datë 26.11.2020 “*Kalim për kompetencë*”, MASR ia ka deleguar këtë kërkesë Qendrës së Shërbimeve Arsimore, të cilët janë shprehur me shkresën nr. 4937/1 prot., datë 02.12.2020 “*Kthim përgjigje*”. Me shkresën nr. 538, datë 16.06.2021 “*Kërkesë për ekuivalentim diplome*” Prefekti i Qarkut Gjirokastrë i është drejtuar përsëri AFA-s për ekuivalentimin e Diplomës së z. M.G. dhe kjo e fundit është shprehur me shkresën nr. 2042.2 prot., datë 25.06.2021 “*Kthim përgjigje*”.

Në zbatim të Udhëzimit nr. 17, datë 03.08.2016, të MASR “*Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njehsimin në RSH, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit*”, i ndryshuar, aplikimi për njehsimin e diplomave kryhet individualisht *on-line* në portalin e-Albania nga nëpunësi dhe jo nga institucioni ku punon dhe përgjegjësinë për mos ekuivalentimin e Diplomës e ka vetë z. M.G.. Për sa më sipër, Prefekti i Qarkut Gjirokastrë është angazhuar maksimalisht me të gjitha mënyrat për t’i ardhur në ndihmë nëpunësit civil për zgjidhjen e problemit, që prej vitit 2016 e në vijim.

Lidhur me masat disiplinore, ky institucion ka informuar se ndaj z. M.G. është dhënë masa disiplinore “*vërejtje*” në muajin tetor 2021.

Prefekti i Qarkut Gjirokastrë ka dërguar bashkëlidhur shkresës së tij, aktet e kërkuara nga KMD.

- Në vijim të shkresave të sipërcituara , KMD iu drejtuar MAS nëpërmjet shkresës nr. 1543, datë 08.11.2021, ku i kërkon informacionin e mëposhtëm:
- Informacion nëse MASR është institucioni përgjegjës për ekuivalentimin e diplomave të lëshuara nga institucionet arsimore me profil ushtarak, në vendet e huaja;
- Nëse, po lutemi të informohet KMD, se sa diploma të tilla, të lëshuara nga institucione arsimore ushtarake, janë ekuivalentuar 3 (tre) vitet e fundit;
- Informacion nëse z. M.G. ka paraqitur kërkesë me shkrim, pranë MAS, për ekuivalentim të diplomës së fituar, në Shkollën e Lartë Shumëdegëshe të luftës në Greqi;

MAS dërgoi për dijëni të KMD-së, shkresën nr. 6364/1, datë 15.11.2021, nëpërmjet së cilës ia përcjell shkresën nr. 1543, datë 08.11.2021, për kompetencë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

- Qendra e Shërbimeve Arsimore<sup>7</sup> dërgoi shkresën nr.5657/1 prot., datë 25.11.2021, ku sqaron se kompetenca për njohjen dhe njehsimin e niveleve 5-8 i ka kaluar Qendrës së Shërbimeve Arsimore në vitin 2018.

Në kohën që kjo kompetencë i ka kaluar QSHA-së ka qenë në fuqi Udhëzimi i Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.17, datë 03.08.2016 *“Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njehsimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit”* i ndryshuar.

Në bazë të Kreut I, pika 2, shkronja v) të këtij Udhëzimi, parashikohet se: *“...QSHA nuk trajton...diploma ose certifikata të fituara në institucione ushtarake të arsimit të lartë, përjashtuar diplomat për drejtime civile të studimeve”*, QSHA nuk ka njehsuar diploma me drejtime ushtarake.

Në datën 25.10.2021 ka hyrë në fuqi Udhëzimi i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit nr. 21, datë 15.10.2021 *“Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njehsimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar”*. Në Kreun I, pika 5, shkronja d) të këtij Udhëzimi parashikohet se: *“Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njehsimin në Republikën e Shqipërisë nuk shqyrton aplikimet për rastet më poshtë:*

*.....certifikata, diploma dhe grada ushtarake të fituara në institucione ushtarake të arsimit të lartë, përjashtuar diplomat për drejtime civile të studimeve. Personat që zotërojnë certifikata, diploma dhe grada ushtarake të fituara në institucione ushtarake të arsimit të lartë, në funksion të ushtrimit të së drejtës për punësim në institucione me karakter ushtarak, i drejtohen institucioneve përgjegjëse në Republikën e Shqipërisë për fushën ushtarake, për njohjen dhe njehsimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi”*

Referuar dispozitës së mësipërme, QSHA nuk mund të shqyrtojë diploma me karakter/drejtim ushtarak të lëshuara nga institucionet ushtarake të arsimit të lartë.

- C. Në vijim të procedurave hetimore, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 26.11.2021, ora 11:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore morën pjesë ankuesi M.G., përfaqësues nga Departamenti i Administratës Publike dhe përfaqësuesi i Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë.

---

<sup>7</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën QSHA;

Në këtë seancë dëgjimore, ankuesi parashtrori edhe një herë pretendimet e tij për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e Departamentit të Administratës Publike dhe Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë.

Për sa më sipër, ai u shpreh në vitin 2016 ka filluar punë në pozicionin e specialistit në Sektorin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile pranë Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë dhe në vitin 2017 ka fituar statusin e nëpunësit civil. Z. M.G. shprehet se pas studimeve të kryera në Shkollën e Bashkuar, ai ka fituar Diplomën e Shkollës së Lartë Shumëdegëshe të Luftës, Selanik, Greqi. Në vitin 2020, pozicioni i përgjegjës të sektorit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile pranë Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë është shpallur vakant dhe ankuesi ka aplikuar për të konkuruar në këtë pozicion pune, pasi kishte edhe dakordësinë e eprorit aktual. Në përfundim të fazës së parë njoftohet me e-mail nga Sekretari i Përgjithshëm i Prefekturës se është skualifikuar për mospërmbushje të nivelit master shkencor/profesional. Në vijim, ai ka depozituar ankesë pranë Departamentit të Administratës Publike dhe ky i fundit vendosi pezullimin e procedurës së konkurrimit. Pas korrespondencës me institucionet respektive, DAP e njofton se ka rënë shkak i pezullimit dhe konkurrimi duhet të vazhdojë. Ndërkohë që, Prefekti i Qarkut Gjirokastrë e ka bërë me dije se duhet të interesohet vetë pranë institucioneve kompetente për të kryer njehsimin e diplomës së tij përfituar në Shkollën e Lartë Shumëdegëshe të Luftës, Selanik, Greqi. Ankuesi sqaron se që në vitin 2016 i ka kërkuar Prefektit të interesohet për çështjen e njehsimit të diplomës së tij. Prefekti ka dërguar shkresë pranë MASR. Kërkesa e tij e fundit drejtuar AFA-s daton në muajin qershor të vitit 2021. Përgjigjet e këtij institucioni kanë qenë konfuze, lidhur me kompetencën e institucionit që duhet të kryente njehsimin. Ankuesi pretendon se Akademia e Shtabit të Përgjithshëm e ka vlerësuar diplomën e tij si Master Shkencor. Ai u shpreh se njehsimi bazohet në urdhërat që nxjerr ministria përgjegjëse.

Përfaqësuesit e KMD-së u informuan se nga përgjigjia zyrtare e ardhur nga AFA, rezuton se ky autoritet nuk mund të kryejë ekuivalentimin e diplomave ushtarake, pasi këtë kompetencë e ka MASR dhe përkatësisht Qendra e Shërbimeve Arsimore. Ndërkohë që, Ministria e Mbrojtjes sqaron se nuk mund të kryhet ekuivalentimi i diplomave të përfituara në vendet e tjera dhe se ky institucion nuk është në proces njehsimi të diplomës së z. M.G.. Në këto kushte, përfaqësuesit e KMD-së ngritën pyetjen ndërmjet palëve në proces, se cili ishte institucioni kompetent për të kryer njehsimin e diplomës së ankuesit.

Përfaqësuesit e DAP sqaruan se problematika lidhur me çështjen e njehsimit të diplomave me drejtim ushtarak, lidhej me miratimin e një udhëzimi të përbashkët ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Përfaqësuesit e Departamentit të Administratës Publike sqaruan gjithashtu se ankuesi ka aplikuar për konkurrim në pozicionin e sipërcituar në vitin 2020. Mbështetur në ankesën e z. M.G., procedura e pezullimit është kryer për të verifikuar pretendimet e tij. Mbështetur në legjislacionin

mbi shërbimin civil, verifikimin e kandidatëve e kryen Prefektura e Qarkut Gjirokastrë. Në kushtet kur, nga ana e ankuesit është depozituar ankesë pranë DAP, ky i fundit ka pezulluar procedurat e konkurrimit për të sqaruar situatën. Ministria e Mbrojtjes ka ekuivalentuar diplomën e marrë nga ankuesi në Shqipëri si të nivelit Bachelor. Në aplikim, ankuesi ka depozituar edhe diplomën e përfituar në Greqi. Procesi i njehsimit kryhet vetëm për diplomat e marra jashtë shtetit, ndërkohë që ai i ekuivalentimit kryhet nga MASR për diplomat e lëshuara nga institucionet arsimore shqiptare sipas viteve. Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk ka tagër të kryejë njehsimin e diplomave të huaja me karakter ushtarak. Ministria e Mbrojtjes, në korrespondencën zyrtare të patur me DAP ka sqaruar se autoriteti kompetent për të kryer këtë proces është AFA. Referuar shkresës nr. 4301/4 prot., datë 23.10.2020, për t'u kryer njehsimi i diplomave të huaja, Ministria e Mbrojtjes duhet të bashkëpunojë me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Të pyetur nëse ka patur probleme të ngjashme më herët, përfaqësuesja e DAP u shpreh se nuk ka dijeni nëse Ministria e Mbrojtjes ka bërë njehsime të tilla më parë. Në kushtet kur, ra shkaku i pezullimit, DAP-i vijoi me procedurat e konkursit, i cili është mbyllur pa kandidat fitues. Në vitin 2021, pozicioni i sipërcituar u shpall sërish vakant dhe u procedua fillimisht me procedurën e lëvizjes paralele, ku ankuesi nuk ka aplikuar. Fitues është shpallur z. E.A.

I pyetur nga përfaqësuesit e KMD-së, se ku mendonte se ishte diskriminuar në kushtet kur ai nuk kishte konkurruar në procedurën e vitit 2021, ai u shpreh se nuk e dinte që ishte rishpallur procedura për këtë pozicion pune dhe se kjo procedurë është mbajtur e fshehtë. Ai u shpreh se edhe pse nuk ka aplikuar për këtë pozicion pune, në vazhdimësi ka komunikuar me DAP, pasi është penalizuar padrejtësisht në konkurrimin e vitit 2020. I pyetur sërish nga përfaqësuesit e KMD-së, se për sa kohë nuk kishte aplikuar për pozicionin vakant të përgjegjës të sektorit, cilat ishin veprimet e DAP që e kanë penalizuar, ankuesi u përgjigj se komunikimi i tij me DAP ishte në tagrin e personit që ishte penalizuar në konkurrimin e vitit 2020 dhe që priste të sistemohej. Ai u shpreh se nëse do të aplikonte, përgjigja për të do të ishte sërish e njëjtë, sepse institucioni nuk do ta përzgjidhte.

Përfaqësuesi i Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë sqaroi se pas ristrukturimit të institucionit në vitin 2016, ish-specialisti i Sektorit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile, z. Th.K., pranë Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë ka fituar pozicionin e përgjegjës të sektorit. Në këtë periudhë kohore është emëruar në detyrë z. M.G. në pozicionin e specialistit pranë këtij sektori. Pas emërimit të tij në detyrë, Prefektura e Qarkut Gjirokastrë i ka bërë kërkesë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për ekuivalentimin e diplomës së tij. Për diplomën e fituar në Greqi, MASR nuk është shprehur dhe nuk ka kryer njehsim. Në këto kushte, institucioni i është drejtuar AFA-s. Bordi përkatës në Ministrinë e Mbrojtjes ka qenë funksional deri në vitin 2016. Kërkesat e Prefekturës për njehsim të diplomës së z. M.G. janë dërguar më pas. Pavarësisht kësaj, përfaqësuesi i Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë thekson faktin se ankuesi duhet të kishte depozituar individualisht kërkesë para Bordit, pasi diploma e tij është lëshuar në vitin 2007.

Pretendimi i ngritur nga ankuesi kundrejt Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë konsiston në faktin se përse në vitin 2016, është emëruar një person tjetër në të njëjtat kushtet me të, në pozicionin e përgjegjës të sektorit. Përgjigja është se në vitin 2016, kriteret ishin të ndryshme nga viti 2019 e në vijim. Në vitin 2017, mbi bazën e kërkesës së Ministrisë së Brendshme dhe DAP është vendosur unifikimi i kriterëve për një grup pozicionesh pune. Përfaqësuesja e DAP sqaroi se Ministria e Brendshme lëshon udhëzimet përkatëse lidhur me çështje të kësaj natyre në prefektura. Përfaqësuesi i Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë u shpreh se për sa kohë ankuesi nuk disponon një diplomë të njehsuar nga autoriteti përkatës, diploma përkatëse nuk mund të merret në konsideratë. Ai theksoi faktin se në vitin 2017, pas ristrukturimit të të gjithë prefekturave në nivel kombëtar, janë përditësuar edhe kriteret për të gjitha pozicionet e punës. Përfaqësuesja e DAP pohoi faktin se është kryer unifikimi i kriterëve për të gjitha pozicionet e punës në prefektura në këtë periudhë kohore. Prefektura e Qarkut Gjirokastrë nuk mund të shprehet për çështje që nuk janë në kompetencën e saj. Në cilësinë e provës, përfaqësuesi i këtij institucioni dorëzoi në seancë dëgjimore disa akte që vërtetohin pretendimet e tij.

Përfaqësuesja e DAP sqaroi në vijim se legjislacioni mbi nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij përcaktojnë normat e përgjithshme mbi punësimin në administratë, ndërkohë që rregullat e detajuara parashikohen nga strukturat përgjegjëse. Të gjitha prefekturat në Republikën e Shqipërisë janë ristrukturuar, duke unifikuar strukturat e tyre. Shkresa e Ministrisë së Brendshme nuk mund të kishte fuqi prapavepruese mbi emërimet të kryera para hyrjes në fuqi të një akti ligjor/nënligjor, sipas parimit të sigurisë juridike

## **I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

Ankuesi M.G. ka përfunduar studimet në vitin 1985 në Shkollën e Lartë të Bashkuar dhe me Vendimin Nr. 4, datë 25.07.1985, të Komisionit Shtetëror është diplomuar oficer për specialitetin “Gjitharmësh”. Në vijim, përgjatë periudhës kohore 04.09.2006 – 06.07.2007, z. M.G. ka kryer studimet pranë Shkollës së Lartë Shumëdegëshe të Luftës, në Selanik, Greqi. Në bazë të vërtetimit nr. 9169 prot., datë 11.08.2016, të lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura rezulton se me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 46, datë 25.07.1985, z. M.G. është titulluar oficer aktiv dhe si i tillë ka shërbyer në strukturat e Forcave të Armatosura deri në vitin 1992. Me Urdhërin nr. 4251/1, datë 29.09.1992, e Ministrit të Mbrojtjes, “Për thyerje të rënda të disiplinës ushtarake”, ankuesi ka dalë në rezervë dhe i

janë ndërprerë marrëdhëniet financiare në datën 30.09.1992. Me Urdhërin nr. 2923, datë 22.10.1997, e Ministrisë të Mbrojtjes, ai është rritulluar oficer aktiv dhe marrëdhëniet e tij financiare kanë filluar në datën 22.10.1997. Z. M.G. ka shërbyer si oficer aktiv në Forcat e Armatosura, deri në datën 01.10.2012, pasi në vijim nëpërmjet Urdhërit nr. 1781, datë 17.10.2012, të Ministrisë të Mbrojtjes, ka dalë në rezervë. Në vijim, ankuesi është trajtuar sipas nenit 12, të Ligjit nr. 10 142, datë 15.05.2009, “*Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gradës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm*”.

Në vijim të karrierës ushtarake, z. M.G. është bërë pjesë e administratës publike pranë Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë. Ai ka filluar punë pranë këtij institucioni në vitin 2016. Nëpërmjet shkresës nr. 6802 prot., datë 04.11.2016, të Departamentit të Administratës Publike, si dhe me anë Urdhërit nr. 105, datë 10.11.2016, të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, ankuesi është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin specialist në Sektorin e Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, në Administratën e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë. Në vitin 2017, nëpërmjet shkresës nr. 2684/3 prot., datë 21.12.2017, të Departamentit të Administratës Publike, ankuesit i është konfirmuar statusi i nëpunësit civil, në pozicionin specialist në Sektorin e Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave pranë Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Prefektura e Qarkut Gjirokastrë i është drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe për dijëni Ministrisë së Mbrojtjes me anë të shkresës nr. 2024 prot., datë 12.12.2016, nëpërmjet së cilës kërkohet kryerja e ekuivalentimit të diplomave të disa punonjësve, sipas grupit të diplomave të arsimit universitar, për efekt të përcaktimit të pagës së grupit për secilin prej tyre. Njëri prej tyre ka qenë edhe ankuesi M.G., për të cilin theksohet fakti se ai disponon edhe një diplomë të cilën e ka fituar jashtë shtetit.

Në bazë të shkresës nr. 85/1, datë 21.03.2017, të Akademisë së Forcave të Armatosura drejtuar MASR citohet shprehimisht: “*Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, Neni 124, Urdhërit nr. 2012, datë 11.02.2015, të Ministrisë të Mbrojtjes “Për miratimin e tabelës së ekuivalentimit të diplomave të lëshuara nga institucionet ushtarake ndër vite”: .....Diploma e Zotit M.G. me Nr. Regj 5297, datë 25.07.12.1985, 3 vite akademike, 6 semestra ekuivalentohet me diplomë “Bachelor””.*

Për sa më sipër, Ministria e Mbrojtjes ka kryer ekuivalentimin e diplomës së Z. M.G. të përfituar nga Shkolla e Lartë e Bashkuar, duke e cilësuar se është e nivelit Bachelor, ndërkohë



që nuk është shprehur për diplomën e Shkollës së Lartë Shumëdegëshe të Luftës, në Selanik, Greqi.

Në vitin 2020, ankuesi ka aplikuar për pozicionin e përgjegjës të Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, në Administratën e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë. Ky pozicion është shpallur vakant nëpërmjet njoftimit të publikuar në faqen zyrtare të Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë dhe ankuesi ka depozituar dokumentacionin e tij për fazën e lëvizjes paralele, me kod shpalljeje #3056, ku lloji i diplomës është arsim i lartë Ushtarak/Policor/Shkenca Inxhinierike:, niveli minimal i diplomës është “Master Shkencor” dhe kategoria e pagës – III-b.

Për këtë pozicion pune kanë konkuruar 2 (dy) kandidatë, z. M.G. dhe z. F.V.

Në pikën 6 të Kreut VII, të VKM nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Procedura e lëvizjes paralele përfshin dy faza:

a) verifikimin e kandidatëve, të cilët përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;

b) vlerësimin e kandidatëve, ku përfshihen vlerësimi i përvojës në punë, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet pozitive dhe intervista e strukturuar me gojë.”

Në pikën 7 dhe 10, të Kreut VII, të VKM-së së sipërcituar, parashikohet se : “7. Njësia e burimeve njerëzore, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimin të tyre, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim. 10. Kandidatët që nuk kualifikohen, njoftohen individualisht nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit për shkaqet e moskualifikimit, në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak të kandidatëve.”

Për sa më sipër, Njësia e Burimeve Njerëzore e Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë, pasi shqyrtoi dokumentacionin e z. M.G. ka konstatuar se nuk plotëson nivelin minimal të diplomës “Master Shkencor” ose “Master Profesional” të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në Arsim i Lartë Ushtarak/Policor/Shkenca Inxhinierike dhe si rrjedhim e ka skualifikuar ankuesin në fazën e parë të konkurimit, duke e njoftuar atë nëpërmjet e-mailit të datës 17.09.2020. Ndërkohë që, z. F.V. është kualifikuar në fazën e parë të konkurimit për këtë pozicion pune.

Në vijim të e-mailit të sipërcituar, ankuesi ka paraqitur 2 (dy) ankesa pranë Departamentit të Administratës Publike, përkatësisht në datën 21.09.2020 dhe datën 22.09.2020, ku pretendon se skualifikimi i tij është i padrejtë, pasi ai ka aplikuar për njehsimin e diplomës që ka fituar jashtë shtetit, por për shkak të vonesave të Ministrisë së Mbrojtjes nuk e ka marrë ende njehsimin e diplomës.

Ankuesi ka dërguar në cilësi prove pranë DAP, shkresën nr. 2317 prot., datë 21.07.2020, me anë të së cilës Ministria e Mbrojtjes konfirmon se pas procesit të ristrukturimit të Akademisë së Forcave të Armatosura në bashkëpunim me MASR, AFA do të nxjerrë një udhëzim të përbashkët mbi ekuivalentimin e programeve të studimit dhe kualifikimeve të kryera në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, duke theksuar faktin se ky proces, është i papërfundur.

Në këto kushte, në bazë të nenit 66, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative nëpërmjet Vendimit nr. 22, datë 25.09.2020, të DAP, procedura e konkurrimit për këtë pozicion pune është pezulluar. Në këtë kontekst, DAP ka vlerësuar se ndodhen përpara një çështjeje paraprake, e cila është parakusht për të garantuar të drejtat e nëpunësit civil, si dhe zhvillimin e levizjes paralele për pozicionin në fjalë. DAP-i çmoi se pezullimi do të zgjaste deri në momentin që do të zgjidhej situata e njehsimit të diplomës së z. M.G., pra deri në momentin që do të konstatohej rënia e shkakut të pezullimit. Vendimi i sipërcituar i është njoftuar zyrtarisht ankuesit dhe Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë, nëpërmjet shkresës nr. 4548/3, datë 09.11.2020, të DAP.

Në vijim, DAP i është drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes nëpërmjet shkresës nr. 4548 prot., datë 01.10.2020 *“Kërkesë për informacion”* për sqarimin e rastit të z. M.G.. Në përgjigje të saj, Ministria e Mbrojtjes sqaron se ka vënë në dijeni AFA-n, në cilësinë e institucionit publik të arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, pranë së cilës funksionon Bordi i Ekuivalentimit të Diplomave të lëshuara nga vendet e huaja, e cila është në pamundësi për të bërë njehsimin e diplomës së fituar nga z. M.G., në Shkollën e Lartë Shumëdegëshe të Luftës në Greqi. Njëkohësisht, ky institucion sqaron se nuk është në proces të njehsimit të diplomës se ankuesit.

Në këto kushte, DAP ka vlerësuar se ka rënë shkak i pezullimit të procedurës dhe nëpërmjet Vendimit nr. 30, datë 02.11.2020, ka vendosur përfundimin e pezullimit dhe vijimin e fazave të mëtejshme të procedurës së levizjes paralele, për shpalljen me kod # 3056 për pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, në Administratën e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë. Në vijim të përgjigjes së marrë nga Ministria e Mbrojtjes, rezultoi se në datën 15.09.2020, DAP ka komunikuar nëpërmjet e-mailit zyrtar me Prefekturën e Qarkut Gjirokastrë, të cilën e ka bërë me dije se: *“Në përfundim të*

verifikimit paraprak të dokumentacionit të administruar nga ana jonë kandidati z. M.G. skualifikohet për fazën e parë”.

Në vijim, nga aktet e administruara në cilësi prove rezulton se procedura e sipërcituar dhe më pas procedura e pranimit në shërbimin civil për këtë pozicion pune është mbyllur pa një kandidat fitues.

Përveç DAP edhe Prefektura e Qarkut Gjirokastrë ka kryer përpjekjet e saj për të zgjidhur situatën e z. M.G.. Kështu, nëpërmjet shkresës nr. 1128 prot., datë 13.11.2020, të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, me lëndë “*Kërkesë për ekuivalentim Diplome*” drejtuar MASR dhe për dijeni Ministrisë së Mbrojtjes, institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë ka kërkuar informacion mbi ekuivalentimin e diplomës së z. M.G., të përfituar në Shkollën e Lartë Shumëdegëshe të Luftës, në Kursin e 4-të Arsimit të Shtabit të Përgjithshëm të Mbrojtjes Kombëtare në qytetin e Selanikut, Greqi.

Qendra e Shërbimeve Arsimore ka kthyer në përgjigje me anë të shkresës nr. 4937/1, datë 02.12.2020, nëpërmjet së cilës informon se në bazë të Udhëzimit nr. 17, datë 03.08.2016, të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “*Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njehsimin në Republikën e Shqipërisë të diplomave, certifikatave , gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizura jashtë vendit*”, të ndryshuar, aplikimi për njehsimin e diplomave kryhet individualisht *on line* në Portalin e-Albania nga çdo qytetar, ndërkohë që vë në dukje faktin se në bazë të pikës 2, shkronja v), të udhëzimit të sipërcituar QSHA nuk shqyrton diploma ose certifikata të fituara në institucione ushtarake të arsimit të lartë, përjashtuar diplomat për drejtime civile të studimeve.

Në vijim, në kushtet kur, pozicioni i sipërcituar ishte ende vakant, DAP nisi procedurat për rishpalljen e këtij pozicioni pune në vitin 2021, nëpërmjet shpalljes #3605. Nga dokumentacioni i administruar në cilësi prove, sikurse dhe nga pohimi i z. M.G. në seancë dëgjimore rezulton se, ai nuk ka aplikuar për konkurrim në këtë pozicion pune, në procedurën për lëvizje paralele. Lidhur me rishpalljen e këtij pozicioni pune, z. M.G. ka dërguar në adresë të DAP disa kërkesa duke pretenduar se ky pozicion nuk duhet të shpallet vakant, deri në momentin që atij do t’i njihet diploma e përfituar në Greqi. Një kërkesë të tillë DAP nuk e ka marrë në konsideratë për sa kohë që sikurse është cituar edhe në korrespondencën zyrtare të këtij institucioni me KMD-në, theksohet fakti se procedurat e konkurimit udhëhiqen nga parimi i ligjshmërisë dhe mbrojtjes së interesit publik.

Në këtë kontekst, KMD gjykon se në kushtet kur, ankuesi nuk ka aplikuar për konkurrim, nuk mund të ekzistojnë veprime të padrejta dhe disfavorizuese për të në lidhje me procedurën e konkurrimit nga institucionet që janë subjekte kundër së cilave drejtohet ankesa.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon gjithashtu dhe bie dakord me DAP, se në legjislacionin e shërbimit civil nuk gjen parashikim në asnjë dispozitë, fakti se pozicioni në shërbimit civil mbetet vakant deri në plotësimin e kriterëve të posaçme nga kandidati potencial për një pozicion të caktuar pune.

Lidhur me konkurrimin e kryer në bazë të shpalljes së vitit 2020, Komisioneri vë në dukje faktin se në nenin 92, të Ligjit nr. 80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”, është përcaktuar shprehimisht se diplomat, certifikatat e gradat e fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, që i përkasin niveleve nga 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, njihen dhe njehsohen përmes lëshimit të dokumentit zyrtar, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, në përfundim të procedurës zyrtare të njohjes.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se parashikimi ligjor i sipërcituar është detyrues për të gjithë individët, të cilët kanë fituar diploma apo kualifikime për efekt të studimeve të kryera jashtë vendit. Diploma e lëshuar nga institucioni arsimor i huaj nuk mund të ketë njohje të drejtpërdrejtë nga institucionet shqiptare për efekt punësimi, pa u kryer procesi i njehsimit.

Referuar Ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe VKM nr. 243/2015 “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar, personat që konkurrojnë duhet të plotësojnë kushtet minimale, sikurse edhe kriteret e posaçme për pozicionin e punës. Në rast të mosplotësimit të kriterëve përkatëse, ata skualifikohen.

Në këto kushte, KMD gjykon se lidhur me procedurat e konkurrimit për shpalljen me kod #3056, për pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, në Administratën e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, DAP dhe Prefekti i Qarkut Gjirokastrë kanë vepruar konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, pa e ekspozuar ankuesin ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues.

Lidhur me procedurat për rishpalljen me kod #3605 e këtij pozicioni pune në vitin 2021, ankuesi nuk ka aplikuar për të konkuruar për këtë pozicion pune. Në këto kushte, nuk legjitimohet për të pretenduar trajtim të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e subjekteve të

sipërcituara. Në këtë kontekst, KMD gjykon se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e DAP dhe Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

- Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi ka pretenduar gjithashtu se nga ana e Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë është vepruar me dy standarde, pasi për z. Th.K., i cili është emëruar në vitin 2016, në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, në Administratën e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë është përcaktuar vetëm kriteri i të pasurit të diplomës bachelor dhe për analogji e njëjta praktikë duhej zbatuar edhe për të.

Për sa më sipër, nga dokumentacioni i depozituar nga ana e përfaqësuesit të Prefekturës së Qarkut Gjirokastrë në seancë dhe përkatësisht shkresës nr. 1647/1 prot., datë 21.03.2017, së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme me lëndë *“Mbi unifikimin e kriterëve të posaçme”*, drejtuar të gjithë prefekturave në vend, rezulton se me anë të shkresës nr. 1224, datë 27.02.2017, të DAP, kërkohet që Prefekturat e Qarqeve të unifikojnë kriteret e posaçme për pozicione të njëjta pune. Një gjë e tillë kërkohet, pasi DAP e ka konsideruar të pamundur shpalljen dhe organizimin e procedurave për pranimin në shërbimin civil, i cili bëhej në mënyrë të ndarë për grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe për çdo grup të pozicioneve të administrimit të posaçëm. Mbështetur në kërkesën e DAP, Ministria e Brendshme u sugjeron të gjitha Prefekturave kryerjen e unifikimeve për disa pozicione pune. Referuar shkresës në fjalë, për pozicionin *“Përgjegjës në Sektorin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile”*, kriteri unifikues duhet të jetë *“Master Shkencor”*, në Shkollën Ushtarake ose të Policisë/Shkenca Inxhinierike/Shkenca Juridike/Shkenca Ekonomike - 5 vite përvojë në punë, ndërkohë që për pozicionin Specialist pranë së njëjtit sektor është përcaktuar niveli *“bachelor”* në Shkollën Ushtarake ose të Policisë/Shkenca Inxhinierike/Shkenca Juridike. Me ndryshimet strukturore institucionale në vitin 2017, të gjitha Prefekturat adoptuan kërkesën e DAP-it, duke unifikuar kriteret e sipërcituara për këto pozicione pune. Më parë është proceduar në bazë të parashikimeve të Udhëzimit nr. 23, datë 04.02.2003, të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, *“Kriteret e përzgjedhjes së personelit të strukturave të emergjencave civile”*, i cili përcakton kriteret e përgjithshme të të veçanta për pozicionet e punës, por nuk e përmbante parashikimet e përcaktuara në shkresën e sipërcituar. Emërimi i z. Th.K. është kryer në vitin 2016, përkatësisht nëpërmjet shkresës nr. 6057 prot, datë 04.10.2016, të DAP dhe Urdhërit nr. 86, datë 06.10.2016, të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, periudhë kohore kjo kur ende nuk ishte kryer unifikimi i kriterëve të punësimit për pozicionin e punës *“Përgjegjës në Sektorin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile”*.

Për sa më sipër, pas analizës së të gjithë fakteve dhe provave në këtë proces shqyrtimi administrativ të ankesës nr. 172, datë 23.09.2021, së z. M.G., Komisioneri gjykon se Prefekti i Qarkut Gjirokastrë nuk e ka ekspozuar ankuesin ndaj një trajtimi të padrejtë e disfavorizues.

- **Lidhur me çështjen e njehsimit të diplomës së z. M.G. nga autoriteti kompetent.**

Gjatë hetimit administrativ të ankesës së sipërcituar, KMD ka mbajtur korrespondencë edhe me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, sikurse edhe me AFA-n, për të sqaruar përgjegjësinë e subjekteve kundër së cilave drejtohej ankesa, në kuadër të çështjes së njehsimit të diplomës së z. M.G..

Qendra e Shërbimeve Arsimore, pranë MASR ka theksuar faktin se mbështetur në legjislacionin ekzistues, sikurse edhe atë paraardhës, ky institucion nuk mund të shqyrtojë diploma me karakter/drejtim ushtarak të lëshuara nga institucionet ushtarake të arsimit të lartë.

Për sa më sipër, rezulton se sipas Kreut I, pika 2, shkronja v), të Udhëzimit nr.17, datë 03.08.2016, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njehsimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe dhe institucioneve të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, i ndryshuar, QSHA trajton vetëm certifikata dhe diploma të drejtimit civil.

Me hyrjen në fuqi të Udhëzimit nr. 21, datë 15.10.2021, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njehsimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar”, sërish mbështetur në parashikimin e Kreut I, pika 5, shkronja d), QSHA nuk njehson diploma me drejtim ushtarak.

Ndërkohë që, referuar shkresave zyrtare që Akademia e Forcave të Armatosura ka dërguar në adresë të KMD-së dhe ankuesit, krijon konfuzion lidhur me kompetencën e këtij institucioni për të kryer njehsimin e diplomave të huaja të lëshuara nga institucionet arsimore ushtarake jashtë Shqipërisë. Në shkresën drejtuar KMD-së, AFA ka theksuar faktin se njehsimi i diplomave të përfituara jashtë vendit kryhet nga ana MASR.

Ankuesi M.G. ka depozituar pranë AFA-s shkresën nr. 677, datë 25.04.2017 dhe shkresën nr. 176, datë 04.02.2019, ku kërkohet njehsimi i diplomës së tij ushtarake të lëshuar në shtetin grek. Në shkresën nr. 176/1 prot., datë 05.02.2019, të AFA-s dërguar në adresë të ankuesit citohet shprehimisht: “Bazuar në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 124, pika 2, Urdhërit nr. 2012, datë 11.12.2015, të Ministrit të Mbrojtjes “Për miratimin e tabelës së ekuivalentimit të diplomave të lëshuara nga institucionet ushtarake ndër vite”, diploma juaj e lëshuar nga Shkolla e Lartë Shumëdegëshe e Luftës, Greqi, më datë 06.07.2007 nuk plotëson kushtet e bazës ligjore të sipërpërmendur për ekuivalentim me nivel diplome Master i Shkencave ose Master Profesional. Bazuar në Urdhërin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 178, datë 27.01.2017, “Për miratimin e tabelës së ekuivalentimit të kurseve institucionale të kryera jashtë shtetit nga personeli ushtarak i Forcave të Armatosura” Kolegji i Bashkuar i Luftës për tre llojet e forcave (Shkolla e lartë Shumëdegëshe e



*Luftës) i shërben ushtarakëve për të përparuar në gradën Nënkolonel dhe kolonel. Nisur nga sa më sipër, Bordi i Ekuivalentimit nuk ekuivalenton diplomën tuaj me asnjë lloj diplome të nivelit master.”*

Përgjigjia e sipërcituar mund të interpretohet si mosnjehsim i diplomës së ankuesit në diplomë të nivelit master, ndërkohë që në shkresën e drejtuar KMD-së, AFA nuk pranon të ketë kompetencë në njehsimin e diplomave, duke e konsideruar si tagër të MASR.

Prefektura e Qarkut Gjirokastrë ka dërguar gjithashtu shkresën nr. 538 prot., datë 16.06.2021, pranë AFA-s dhe për dijeni pranë Ministrisë së Mbrojtjes, ku kërkohet njehsim i diplomës së ankuesit, por AFA nuk ka kthyer përgjigje.

Në përgjigjen zyrtare që Ministria e Mbrojtjes i ka kthyer DAP-it rezulton se AFA, në cilësinë e institucionit përgjegjës, është në pamundësi për të bërë njehsimin e diplomës së fituar nga z. M.G., në Shkollën e Lartë Shumëdegëshe të Luftës në Greqi. Njëkohësisht, ky institucion sqaron se nuk është në proces të njehsimit të diplomës së ankuesit.

Ndërkohë që në shkresën nr. 2317 prot., datë 18.09.2020, të AFA-s drejtuar ankuesit, ky i fundit bëhet me dije se: *“Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit janë në proces hartimi të udhëzimit të përbashkët për përcaktimin e kriterëve dhe standartit për vlerësimin e nivelit të diplomave të lëshuara nga institucionet e Arsimit të Lartë jashtë vendit për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ndër vite”.*

Njëkohësisht, në bazë të dokumentacionit të përcjellë nga DAP në cilësi prove rezulton se përgjigje e ngjashme është kthyer nga Ministria e Mbrojtjes është për 4 ankues të tjerë, lidhur me çështje analoge. Kështu, z. A.B, z. B.Gj., z. P.T. dhe z. F.H. bëhen me dije lidhur me kërkesën e tyre të datës 13.07.2020, se *“Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes në zbatim të detyrimeve të VKM nr. 156, datë 19.02.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së FA, si institucion i vetëm publik i Arsimit të Lartë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, si dhe organizmin dhe funksionimin e saj” vazhdon të jetë në proces të plotë ristrukturimi, i cili parashikohet të përfundojë në muajin shtator 2020. Për sa më sipër, me konsolidimin e plotë të strukturës së re të Akademisë së Forcave të Armatosura do të fillojë procesi i krijimit të organeve kolegjiale të Rektoratit gjithashtu i grupit të punës me MASR për nxjerrjen e një udhëzimi të përbashkët mbi ekuivalentimin e programeve të studimit dhe kualifikimeve të kryera në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.”*

I njëjti fakt përforcohet edhe në shkresën nr. 4301/1, datë 23.10.2020, e Ministrisë së Mbrojtjes drejtuar DAP.

Për sa më sipër, Komisioneri vë në dukje faktin se në pikën 17, të Vendimit nr. 156, datë 19.02.2020, të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së FA, si institucion i vetëm publik i Arsimit të Lartë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, si dhe organizmin dhe funksionimin e saj” parashikohet se: “Ekuivalentimi/njëvlershmëria e programeve të studimit dhe të kualifikimeve të kryera në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit, në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, rregullohet me udhëzim të përbashkët të Ministrisë përgjegjëse për Mbrojtjen dhe ministrit përgjegjës për arsimin”. Ky udhëzim ende nuk është miratuar, duke krijuar konfuzion lidhur me procedurat që duhen ndjekur për kryerjen e njehsimit, mbi institucionet e involvuara në këto procedura, si dhe mbi kompetencat që këto institucione kanë në këtë proces, lidhur me njehsimin e diplomave me drejtim ushtarak.

Në këto kushte, KMD gjykon se është mungesa e aktit përkatës nënligjor të miratuar nga institucionet kompetente, përkatësisht Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, që ka penguar ankuesin të njehsojë diplomën e tij të përfituar në Greqi.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pikat 1 dhe 3, nenit 12, nenit 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-12, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. M.G., për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë dhe Departamentit të Administratës Publike.
2. Rekomandohet që Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Arsimit dhe Sportit të marrin masat e nevojshme për të miratuar sa më shpejt Udhëzimin e Përbashkët për ekuivalentimin e programeve të studimit dhe të kualifikimeve të kryera në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit, në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.

3. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkak – Gjendja arsimore  
Fusha – Punësim  
Lloji i vendimit - mosdiskriminim